



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:154498
Datë: 21.10.2024
Numri i dokumentit: 06327351

Ac.nr.7474/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.Rr. dhe F.G., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av.F.B., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i pagës së 13 (trembëdhjetë) dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5367/21, të datës 12.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.10.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5367/2021, i datës 12.10.2023, **vërtetohet**.

II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5367/2021, të datës 12.10.2023, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.5367/2021, të datës 12.10.2023, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si e themeltë kërkesëpadinë e paditësve R.Rr. dhe F.G., dhe e ka detyruar të paditurën Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim: - Paditësit të parë R.Rr., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, t’ia paguaj për çdo vit, shumën nga 657.66 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,972.98 € dhe Paditësit të dytë F.G., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018, 2019 dhe 2020, t’ia paguaj për çdo vit, shumën nga 657.66€, apo shumën e përgjithshme prej 1,972.98 €. Në pikën II të dispozitivit është obliguar e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, të ju paguaj paditësve, shumat e gjykuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në shkallë prej 8 % në vit, e cila fillon të

llogaritet nga data 08.07.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 216.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën III të dispozitivit janë refuzuar kërkesat e paditësve me të cilat kanë kërkuar për ta detyruar të paditurën që paditësve të ju paguaj në emër të shujtave ditore nga 2.50 € për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, nga data 14.11.2018 e deri në realizimin e kësaj të drejte, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prish aktgjykimin C.nr.5367/2021, të datës 12.10.2023 dhe çështjen të kthejë në rivendosje, ose të refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pathemeltë.

Paditësit përmes përfaqësueses së autorizuar kanë paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzojë ankesën e të paditurës si të pathemeltë dhe të vërtetojë aktgjykimin e ankimuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përgjigje në ankesën shumën prej 156 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit përmes përfaqësueses së autorizuar, me datën 14.07.2021, kanë ushtuar padi kundër të paditurës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, shujtave si dhe shpenzimet e procedurës, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë ashtu që paditësve në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, dhe 2020 dhe t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar paditën e paditësve duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave pa shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.5367/2021, të datës 12.10.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës për secilin paditës dhe atë për paditësin e parë nga vërtetimi i datës 05.04.2002 dhe për paditësin e dytë nga vërtetimi i datës 30.03.2021, nga i cili vërtetim gjykata konstatoi se paditësi

i parë tek e paditura realizon pagë mujore në shumë prej 657.66€, ndërsa paditësi i dytë tek e paditura realizon pagë mujorë në shumë prej 657.66€, këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësve t'ua kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm de kontradiktor me arsyetimin. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon dhe lartësia e pagës bazë, për çka edhe me rastin e vendosjes drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29 par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nen shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe detyruar të paditurën që paditësit t'ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore

në emër të pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të përfomances, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas Gjykatës së Apelit, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personeli i policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ me numër 02/2018, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit duke vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën III të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik andaj, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7474/23, me datë 21.10.2024

Kryetarja e Kolegjit-Gjyqtarja
Naime Ahmeti